



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:043067
Datë: 14.05.2024
Numri i dokumentit: 05679344

C-IV-21-0166

Parashtruesi i kërkesës

Gj G, A Prizren

kundër

Pala kundërshtare

Agjencia Kosovare e Privatizimit – AKP (N.SH. “Famipa” në Likuidim), Rr. “Dritan Hoxha” nr. 55, Lakrishte, Prishtin.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (DHPGJS), sipas gjyqtarit Gazmend Sylaj, me 14 maj 2024, lëshon këtë:

AKTGJYKIM

- I. Ankesa e ankuesit refuzohet si e pabazuar.**
- II. VËRTETOHET vendimi i Autoritetit të Likuidimit PRZ024-0443 datë 9 shtator 2013.**
- III. Secila palë i bartë shpenzimet e veta.**

Rrethanat faktike dhe procedurale

Me 24 shtator 2013, ankuesi parashtror kërkesë për rishqyrtimin e Vendimit të Autoritetit të Likuidimit (në tekstin e mëposhtëm AL) PRZ2024-0443 i datës 9 shtator 2013, (në tekstin e mëposhtëm Vendimi), me të cilin i është refuzuar si e pa vlefshme kërkesa për kompensim e tri pagave të papaguara në shumë prej 742.00 (shtatë katër dy) Euro, nga N.SH. “Famipa” (në Likuidim).

Ankuesi ndër të tjerash pohon se, AL me rastin e shqyrtimit të kërkesës kreditore gabimisht ka vërtetuar gjendjen faktike dhe si dhe gabimisht ka aplikuar të dispozitat materiale.

Ankuesi konsideron se AL me rastin e Vendosijes gabimisht ka zbatuar dispozitat ligjore të Ligjit për AKP me Aneksin e saj, duke ju referuar neneve 2, 23, 37 39 , 40 paragrafit 1.6.1 dhe 1.6.2 dhe nenit 42 paragrafi 1.

Nga gjitha arsyet kërkon nga gjykata marrjen e një vendimi të drejtë me rastin e shqyrtimit të kërkesës-ankesës.

Duke vepruar sipas urdhrin të gjykatës të datës 10 janar 2014, ankuesi me 21 janar 2014 parashtronj:

- Kopjen e Vendimit të AL,
- Kopjen e Njoftimit lëshuar nga ana e AKP, e datës 16 shtator 2011. Sipas këtij njoftimi shihet se ankuesi i është ndërprerë marrëdhënia e punës duke filluar nga data e lëshimit, si rezultat i shitjes përmes tenderit dhe se pagat – shumat e papaguara do të mbesin përgjegjësi e punëdhënësit (në tekstin e mëtutjeshëm NJOFTIMI).
- Kopjen e njoftimit drejtuar ankuesit, e datës 12 qershor 2012.
- Kopjen e Vendimit mbi themelimin e marrëdhënies së punës, lëshuar nga NSH me 22 Prill 1985.

Me 1 Prill 2014, ankuesi parashtronj kërkesën e kërkuar, nga gjykata, për ndihmë në përkthim.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 11 korrik 2014, parashtronj përgjigjen.

AKP pohon se kërkesa është e pabazuar. AKP fillimisht pohon se AL ka bërë një vlerësim të saktë të rrethanave faktike dhe se dispozitat ligjore i ka zbatuar në mënyrë të drejtë. AKP gjithashtu pohon se në bazë të dhënave nga arkivi i NSH nuk ka asnjë detyrim ndaj ankuesit. Po sipas këtyre të dhënave ankuesi nuk ishte pjesë e listë pagesës së pagave së gjashtë muajve të fundit. AKP konsideron se ankuesit nuk i ka pushuar marrëdhënia e punës si pasojë e veprimit të saj andaj edhe nuk i takon e drejta e kompensimit si dëmshpërblim për ndërprerje të marrëdhënies së punës, ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 paragrafi 1.6.1 dhe 1.6.2 të Shtojcës së Ligjit për AKP. Nga të gjitha arsyet propozoj që kërkesa të refuzohet si e pabazuar dhe vendimi i atakuar të vërtetohet.

Përgjigjes i janë bashkangjitur:

- Kopja e Vendimit për emërimin e anëtarëve të AL, dhe
- Listën e pagave të punëtorëve të NSH, për muajt prill gjer shtator të vitit 2010.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, ankuesi me 11 gusht 2014, parashtronj përgjigjen.

Ankuesi mbetet në tërësi si pranë kërkesës për rishikim-ankesës.

Bazuar në urdhrin e gjykatës, AKP me 9 shtator 2014 parashtronj kundërpërgjigjen.

AKP mbeti në tërësi si pranë përgjigjes.

Gjykata me Aktvendimin C-IV-13-1798 datë 5 tetor 2020 aprovoj kërkesën e ankuesit, shfuqizoj Vendimin e AL dhe obligoj AL që kërkesën kreditore ta rishqyrtoj.

Kolegji i Apelit i DHPGJS (KA), me Aktvendimin e saj AC-I-20-0463-A0001 datë 29 shtator 2021, aprovoj ankesën e AKP dhe anuloj Aktvendimin e gjykatës datë 25 gusht 2021.

KA në arsyetimin e vendimit, ndër të tjerash theksoj që gjykata duhet të vendos vet në meritat e ankesës së ankuesit.

Me 29 maj 2023, gjykata lëshoi një urdhër për parashtruesin e kërkesës, përmes së cilit ju kërkua që të parashtrorj të gjitha faktet materiale që kanë të bëjnë me kërkesën ose ankesën dhe një listë provash që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e papaguara, në shumën e kërkuar si dhe ju kërkua që të paraqesë prova fizike për mbështetjen e atij pohimi.

Urdhri ju dorëzua ankuesit me 2 maj 2023.

Ankuesi nuk ka parashtruar përgjigje.

Arsyetimi ligjor

Kërkesa për rishikim-ankesa konsiderohet e pabazuar.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit për DHPGJS (ligji nr.06/L-086) në lidhje me nenin 399 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa nuk e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Në rastin konkret bazuar sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS është obligim i palës, në këtë rast ankuseses, që në parashtruesat e saj me shkrim, ankesën, të paraqesë një pasqyrë të hollësishme të fakteve dhe arsytimit ligjor mbi të cilin vendos qëndrimin dhe argumentimin e saj. Në rastin kur pala pohon, në këtë rast ankuesja, të ekzistojë një fakt, ajo palë është e obliguar të paraqesë prova, fizike dhe/ose dëshmuese, për mbështetjen e atij pohimi.

Nga dispozita e cekur si më lartë, është obligim i ankuesit që të dëshmoj detyrimet ndaj tij, mbi mos pagesën e të ardhurave personale.

Lidhur me pagat e papaguara si dhe kompensimit, si rezultat i shitjes apo privatizimit apo edhe likuidimit nga ana e AKP, duke u bazuar në nenin 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP mbi prioritet e kërkesave dhe interesave, paragrafi 1.6 pika 1.6.1 parashihet përmbushja e kërkesave për pagat e punonjësve të cilat nuk janë paguar deri në datën e vendimit nga Gjykata apo Agjencia për fillimin e procedurave të likuidimit, të kufizuar në tri paga mujore bruto për person.

Nga dispozita e lartë cekur, mund të konkludohet se, punëtori gëzon të drejtën në paga respektivisht dëmshpërblim nëse:

- a. Pagat e punonjësit, në këtë rast ankuesit, nuk janë paguar.

Në këtë rast ankuesi nuk ka ofruar ndonjë dëshmi relevante që dëshmon se NSH i ka mbetur borxh pagat e kërkuara si dhe nuk ka ofruar ndonjë dëshmi lidhur me lartësinë dhe llogaritjen e pagave të kërkuara. Për më tepër ankuesi ka dështuar që të dorëzojë prova relevante edhe pas urdhrit të lëshuar nga gjykata. Ankuesi zgjodhi që të heshtë dhe mos ti përgjigjet të njëjtës. Gjykata gjen se në mungesë të dëshmive, pretendimet e ankuesit lidhur me të drejtën e tij në kompensim për paga të pa paguara, nuk janë të mbështetura me provat e nevojshme materiale, prandaj si të tilla janë refuzuar si të pabazuara.

Në anën tjetër AKP me përgjigjen e saj sipas listës së prezantuar së pagave të punëtorëve të NSH, dëshmoj të kundërtën e pohimeve dhe pretendimeve të ankuesit.

Nga gjitha arsyet ankuesi nuk ka dëshmuar të drejtën e tij mbi pagat ashtu siç edhe parashihet sipas nenit 40 të SHTOJCËS së Ligjit për AKP, paragrafi 1.6 pika 1.6.1, por edhe nuk ka

dëshmuar ndonjë obligim tjetër ashtu siç parashihet sipas nenit 31 paragrafi 4 dhe 5 dhe nenit 35 paragrafi 2.4 të Ligjit për DHPGJS.

Nga gjitha arsyet u vendos si në dispozitiv.

Shpenzimet gjyqësore

Në pajtim me nenin 13.3 të Udhëzimit Administrativ për Unifikimin e Taksave Gjyqësore, të Këshillit Gjyqësor të Kosovës (KGJK) nr. 01/2017, të datës 22 mars 2017, nuk caktohen taksa gjyqësore, në këtë procedurë ankimore, pasi që vlera e kontestit është 1,000.00 €.

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për DHPGJS, secila palë do ti mbulojë shpenzimet e veta.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

Këshilla juridike

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të DHPGJS brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për DHPGJS.

Gazmend Sylaj, Gjyqtar